



Nr. 02/ZDP/VE/2014

Datë: 6 mars 2014

Në mbështetje të neneve 14.1, 14.2, 15.1 (f), 21.1 dhe 81 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, 4 qershor 2008), dhe nenit 11 të Rregullores nr. 01/2011 për tarifatat e aeroportit, datë 18 janar 2011,

Duke vendosur sipas propozimit (Ref. 2014/ZDP/07-2) të operatorit të aeroportit, LKIA ANP "Adem Jashari" ("operatori i aeroportit"), datë 3 shkurt 2014, për modulim të tarifave të aeroportit,

Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës nxjerr këtë:

#### VENDIM

1. Miratohet Programi Nxitës për ANP "Adem Jashari" sipas propozimit të operatorit të aeroportit, Ref. 2014/ZDP/07-2, dt. 3 shkurt 2014, duke filluar nga data 30 mars 2014 deri më datën 29 mars 2015.
2. Çdo ndryshim i Programit Nxitës duhet të bëhet në pajtim me Rregulloren nr. 01/2011 për tarifatat e aeroportit.
3. Obligohet operatori i aeroportit që t'ua ofrojë Programin Nxitës të gjitha kompanive ajrore që operojnë apo që do të operojnë në ANP "Adem Jashari", në mënyrë jo-diskriminuuese, ta publikojë këtë program në mënyrë të përshtatshme si dhe ta informojë AAC-në mbi zbatimin e këtij programi.

#### Arsyetim

Operatori i aeroportit ka dorëzuar Programin Nxitës për marrjen e miratimit nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës ("AAC") më dt. 3 shkurt 2014.

Në Programin Nxitës thuhet se ai ka për qëllim rritjen e trafikut në këtë aeroport, përmes nxitjes për zhvillimin e linjave të reja, nxitjes për zhvillimin e frekuencave shtesë, kompensimit për kompanitë ajrore që kanë vëllim të lartë trafiku, mbështetjes së kompanive ajrore që kanë faktor të ulët të ngarkesës së aeroplanit dhe mbështetjes së aktiviteteve të marketingut për kompanitë ajrore që hapin linja të reja apo shtojnë frekuencat ekzistuese.

Me qëllim të marrjes së miratimit të AAC-së për programin e tij nxitës, operatori i aeroportit ka dorëzuar këto dokumente për shqyrtim:

- Programin Nxitës të operatorit të aeroportit ANP "Adem Jashari", dt. 3 shkurt 2014;
- Ftesën që i është bërë kompanive ajrore për të marrë pjesë në Komitetin Konsultues të Shfrytëzuesve të Aeroportit ("Komiteti Konsultues") për të diskutuar mbi Programin Nxitës të propozuar;
- Procerverbalin e miratuar të mbledhjes së Komitetit Konsultues, mbajtur më 4 mars 2014;
- Listën e pjesëmarrësve në mbledhje të Komitetit Konsultues;

Në bazë të detyrave dhe përgjegjësi të AAC-së sipas nenit 15 (f) të Ligjit për Aviacionin Civil si dhe nenit 11 të Rregullores nr. 01/2011 për tarifën e aeroportit, AAC-ja ka bërë shqyrtimin e këtyre dokumenteve dhe ka konstatuar se:

- Programi Nxitës i propozuar është një iniciativë transparente dhe inkurajim i mirë për kompanitë ajrore që të fillojnë linja të reja ose të shtojnë numrin e fluturimeve nga ANP "Adem Jashari". Zbatimi i këtyre nxitjeve do të jetë i dobishëm për publikun duke iu ofruar mundësi më të madhe zgjedhjeje për të udhëtuar nga ANP "Adem Jashari".
- Kushtet për dhënien e secilës prej pesë nxitjeve të ofruara në Programin Nxitës, të propozuara nga operatori i aeroportit, janë relevante, objektive dhe transparente.
- Programi Nxitës u ofrohet të gjitha kompanive ajrore, pa asnjë përjashtim, të cilat operojnë ose planifikojnë të operojnë nga ANP "Adem Jashari", e që i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara në Programin Nxitës.
- Programi Nxitës është i kufizuar në kohë dhe është efektiv prej dt. 30 mars 2014 deri më 29 mars 2015.
- Procesverbali i mbledhjes së Komitetit Konsultues, i datës 4 mars 2014, tregon se kompanitë ajrore nuk kanë shprehur mospajtim me Programin Nxitës të prezantuar nga operatori i aeroportit.

Duke marrë parasysh se Programi Nxitës i operatorit të aeroportit ANP "Adem Jashari" ka për qëllim promovimin e hapjes së linjave të reja, është i kufizuar në kohë për një (1) vit dhe është proporcional me arritjen e objektivit të synuar, mund të përfundojë se, si i tillë, ky program është në interes të përgjithshëm dhe publik dhe se është në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 01/2011 për tarifën e aeroportit.

Pasi që Programi Nxitës mund të ketë implikime financiare edhe për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si nënshkruese e Marrëveshjes për Partneritet Publiko-Privat, nr. 09-001-611, datë 12 gusht 2010, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Partnerit Privat për koncesionimin e ANP "Adem Jashari", përmes korrespondencës elektronike të datës 4 shkurt 2014, Departamenti Qendror i Partneritetit Publiko Privat i Ministrisë së Financave ka konfirmuar se nxitjet mund të ofrohen me kusht që të njëjtat të aprovohen nga AAC-ja si rregullator ekonomik.

Prandaj, në bazë të këtyre fakteve mund të konkludohet se Programi Nxitës i operatorit të aeroportit është në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 01/2011 në lidhje me modulimin e tarifave.

Duke u mbështetur mbi këtë bazë ligjore, Drejtori i përgjithshëm ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



**Dritan Gjonbalaj**  
Drejtor i përgjithshëm

**Udhëzim mbi mjetin juridik:**

Kundër këtij vendimi mund të kërkohet rishikim administrativ pranë Komisionit të Ankesave të AAC-së, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të vendimit.

Iu dërgohet:

- ANP "Adem Jashari" - LKIA, Vrellë, Komuna e Lipjanit
- Njësisë PPP, Ministria e Financave

Për dijeni:

- Departamentit të Aviacionit Civil, Ministria e Infrastrukturës